VENDIM
Nr.838, datë 22.7.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS QENDËR MALLAKASTËR TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Mallakastër të qarkut të Fierit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër Mallakastër të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.1607, datë 10.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Mallakastër të qarkut të Fierit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Mallakastër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna: Qendër Mallakastër Lidhja nr.1

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
1-14	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE (PRONAT ME NR.RENDOR 13,14 NDODHEN BRENDA GODINËS SË SHKOLLËS)	NË PRONËSI
15-23	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË SHËNDETIN PUBLIK (PRONAT ME NR.RENDOR 18,20,22, NDODHEN BRENDA GODINËS SË SHKOLLËS)	NË PRONËSI
24-27	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE SOCIAL-KULTURORE E SPORTIVE.	NË PRONËSI
28-45	VARREZA PUBLIKE	NË PRONËSI
46-50	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E STREHIMIT DHE MBROJTJES CIVILE.	NË PRONËSI
64	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK.	NË PRONËSI
68-85	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE).	NË PËRDORIM
86-92	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA JOPRODUKTIVE)	NË PRONËSI
226-227	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE.	NË PRONËSI
228-249	INFRASTRUKTURË (SHESHE, RRUGË VENDORE, LULISHTE DHE SHËRBIME PUBLIKE)	NË PRONËSI